



## **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**

### **Fakulteti i Edukimit**

#### **Programi Master: Udhëheqja në arsim**

### **Kursi: Metodatat e hulumtimit në arsim**

**Statusi: Obliguar**

**ECTS:**

**Ligjëruesi/t: Dr. Blerim Saqipi**

**Kontaktet:**

e-mail: [blerim.saqipi@uni-pr.edu](mailto:blerim.saqipi@uni-pr.edu)

### **I. Përshkrimi**

Ky kurs është vazhdimësi e Kursit “Hyrje në hulumtimet arsimore”. Konceptet e adresuar nga aspekti teorik në kursin “Hyrje në hulumtimet arsimore” do të trajtohen nga qasja praktike (dhe më e detajuar) e realizimit të një projekti hulumtues. Kursi ka për synim t’i ekspozojë studentët ndaj hapave kryesor nëpër të cilët duhet të kalohet gjatë realizimit të një projekti hulumtues. Kursi trajton metodatat kualitative, kuantitative dhe të përziera të hulumtimeve arsimore. Në mënyrë të tërthortë kursi trajton llojet e ndryshme të hulumtimeve si përshkruese, historike, eksperimentale, vlerësuese, vepruese, studim rasti etj. Në kuptim më të ngushtë, kursi ndihmon studentët të familjarizohen me konceptin e zgjedhjes dhe definimit të problemit, dizajnin e një projektit hulumtues, hartimin e instrumenteve dhe mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, si dhe procesimin, analizën dhe raportimin e të dhënave dhe gjetjeve të një studimi. Në kuptim më të përgjithshëm, kursi ndihmon studentët të reflektojnë rreth parimeve etike ligjore dhe filozofike të realizimit të një projekti hulumtues si psh hulumtueshmëria, besueshmëria, validiteti, përgjithësimi dhe ruajtja e anonimitetit. Natyra e temave dhe problematikës që do të adresojë kursi do të jenë në përputhje me natyrën e programit dhe si të tilla do të orientojnë studentët edhe drejt kuptimit të problemeve dhe qështjeve kryesore brenda fushës së ngushtë të programit.

### **II. Rezultatet e pritura**

Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë problemin e hulumtimit dhe të hartojnë pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe objektivat e hulumtimeve;
- të kuptojnë dhe të realizojnë lloje të ndryshme të projekteve hulumtuese sasiore

- dhe/apo cilësore (psh hulumtimet eksperimentale, longitudinale, etnografike, historike, fenomenologjike, vlerësuese, vepruese si dhe studimet e rastit);
- të identifikojnë dhe hartojnë instrumentet të ndryshme për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore;
  - të analizojnë, interpretojnë dhe raportojnë të dhënat sasiore dhe cilësore në një projekt studimor;
  - kuptojnë aspektet kryesore etike dhe metodologjike (si validiteti, besueshmëria, përgjithësimi) të realizimit të nje projekti hulumtues.

### III. Metodologjia e mësimdhënies

Metodologjia e mësimdhënies që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt involvimit të studentëve në diskutime. Rëndësi e veçantë kushtohet aspekteve praktike të shtjellimit të temave konkrete ku studentët do të angazhohen në detyra praktike në lidhje me temat përkatëse. Prezantimet e mësimdhënies do të shërbejnë si pikënisje dhe formulim i kornizës brenda së cilës do të orientohet puna e studentëve.

### IV. Plani i detajuar i kursit

Java	Tema	Literatura	Aktiviteti
1	Prezantimi i kursit Paraqitja e syllabusit dhe detyrave		
2 & 3	Elemente themelore të procesit të hulumtimit	[1] A4, B5 [8]	Prezantim për formulim të temave për studim <b>Detyra 1:</b> Në bazë të kushteve të përcaktuara dhe duke shfrytëzuar modelin e ofruar, të hartohet një propozim hulumtimi për një temë sipas zgjedhjes së studentëve. Detyra duhet të dorëzohet brenda dy javësh. (5 pikë)

4&5	Mbledhja e të dhënave sasiore	[1] C3 [2] f. 153-173 [8]	Prezantim për hartimin e pyetësorëve Shembuj pyetësorësh <b>Punë në grupe:</b> Hartimi i pyetësorëve për hulumtimet studentore Implementimi i pyetësorëve (sondazhi) - demonstrim <b>Detyra 2:</b> Të finalizohen pyetësorët për hulumtime studentore dhe të zhvillohet plani për administrimin e tyre . Detyra dorëzohet brenda dy javësh. (5 pikë)
6&7	Analiza e të dhënave sasiore	[1] D1, D3; [8]	Prezantim për punën me të dhëna në përgjithësi Prezantim për analizën statistikore të të dhënave, shoqëruar me shembuj dhe detyra praktike. <b>Detyra 3:</b> Të administrohen pyetësorët dhe të bëhet analiza e të dhënave sasiore. Detyra dorëzohet brenda dy javësh. (10 pikë)
8&9	Mbledhja e të dhënave cilësore	[1] C4-C6	Prezantim për intervistimin, grupin e fokusit, vrojtimin <b>Punë në grupe:</b> Hartimi i protokollit të intervistës/vrojtimit <b>Detyra 4:</b> Të finalizohen protokolet për hulumtime studentore dhe të zhvillohet plani për zhvillimin e intervistave/vëzhgimeve. Detyra dorëzohet brenda një jave (5 pikë)
10&11	Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore	[1] D4-D8	Prezantim për analizën e të dhënave cilësore, shoqëruar me shembuj dhe detyra praktike. <b>Detyra 5:</b> Të zhvillohen intervistat/vëzhgimet dhe të bëhet analiza e të dhënave cilësore. Detyra dorëzohet brenda dy javësh. (10 pikë).
12&13	Nxjerrja e përfundimeve Paraqitja e të dhënave dhe raporti	[1] D10, E1-E3; [8]	Prezantimi për nxjerrjen e përfundimeve me shembuj praktikë Prezantimi për paraqitjen e të dhënave dhe raportet Prezantimi i formatit për raportin hulumtues të grupeve <b>Detyra 6:</b> Raporti (5 pikë)
14	Prezantimi i raporteve përfundimtare		Bëhet prezantimi i disa Projekteve të zgjedhura

## Vlerësimi

Vlerësimi në këtë kurs zbaton qasjen e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në këtë kurs synon jo vetëm të verifikojë aftësitë dhe arritjet e studentit të caktuar por edhe bashkëpunimin e tyre brenda grupit dhe ngritjen e përgjegjësisë për të kontribuar në zhvillimin e kolegëve brenda grupit

Forma e vlerësimit:

1. Detyrat gjatë semestrit (6 detyra) – 40%
2. Provimi final – 60%.

Detajet e vlerësimit për secilën detyrë do të ofrohen në mënyrë të detajuar nga mësimmshënësi i kursit në afat të caktuar. Puna në grupe do të menaxhohet në atë mënyrë që kontributi i secilit anëtarë të grupit do të duhet të dëshmohet me rastin e dorëzimit të detyrës. Detyrat do të jenë detyra në grup ndërsa mësimmshënësi do të bëjë takime individuale me secilin grup për të reflektuar nëse anëtarët e grupit kanë kontribuar të gjithë njësoj dhe të caktohen niveli i pikëve që merr secili anëtarë i grupit. Kjo bëhet në fund të semestrit. Studentët duhet të arrijnë 50% të pikëve të testit final për të shtuar pikët e detyrave.

### Skema e vlerësimit

Pikët	Nota
90-100 %	10
80- 89 %	9
70- 79 %	8
60- 69 %	7
55-59 %	6

### Referenca dhe stili i shkrimit

Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kursit dhe në rast të shfrytëzimit të burimeve të tjera duhet t'i binden rregullave të APA-s.

### Literatura

- [1] Mattheus, B. & Ross, L.: *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale e humane*, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë, 2010.
- [2] Creswell, J. W.: *Educational research, planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research* (3rd ed.). Upper Saddle Creek, NJ: Pearson Education, 2008.
- [3] Kocani, A.: *Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*, Ufo Press, Tiranë, 2008.

[4] Creswell, J. W. : *Mixed methods research*. Thousand Oaks: Sage Publications, 2007.

[5] Creswell, J. W.: *Qualitative inquiry and research design: choosing among five traditions*. Thousand Oaks: Sage Publications, 1998.

[6] Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K.: *Research Methods in Education*. (6th edition). Routledge London, 2007.

[7] Patton, Q. M. : *Qualitative Research & Evaluation Methods*. 3d ed. Sage Publication. Inc, 2002.

[8] Kumar, R. (2014). *Metodologjia e hulumtimit: udhërrëfytes hap pas hapi për fillestar*. Sage Publications.